

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-167/13

Prishtinë, 20 Korrik 2015

Në çështjen juridike të:

S K

Rr.Dj S 81/13

N

Pala ankuese

kundër

F I

Rr. S P, nr.4

I T

Rr. R B , nr.357

Q O

Rr. V G , nr.11

F

Pala përgjegjëse në ankesë

Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës i përbërë nga Sylejman Nuredini, Kryetar i Kolegjit, Willem Brouwer dhe Rolandus Bruin, anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/164/2012 (lënda e regjistruar në AKP me numrin KPA16240) të datës 5 shtator 2012, pas shqyrtimit të mbajtur më 20 Korrik 2015, mori këtë:

AKTGJYKIM:

1. **Aprovohet ankesa e palës ankuese S R K e ushtruar kundër Vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPPC/D/A/164/2012 (për sa i përket lëndës së regjistruar në AKP me numrin KPA16240) të datës 5 shtator 2012.**
2. **Anulohet vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPPC/D/A/164/2012 (për sa i përket lëndës së regjistruar në AKP me numrin KPA16240) të datës 5 shtator 2012.**
3. **Hidhet poshtë si e papranueshme në mungesë të juridiksionit kërkesa e S R K e regjistruar në AKP me numrin KPA16240.**

Përmbledhje e çështjeve procedurale dhe faktike:

1. Më 12 tetor 2006 S R K , ka paraqitur kërkesë në AKP në emër të babait të tij, duke kërkuar ri-posedimin dhe konfirmimin e të drejtës së pronësisë mbi ngastrën nr.137 me sipërfaqe prej 3ha 59 ar, që ndodhet te vendi i quajtur Paunovo Polje, Zona Kadastrale Ferizaj, Komuna Ferizaj (në tekstin e mëtejme: prona). Ai deklaroi se posedimi mbi pronën është humbur për shkak të konfliktit të armatosur të viteve 1998/99, duke cekur 15 qershor 1999 si datën e humbjes. Ai pretendon se prona tani është e uzurpuar ilegalisht nga persona të panjohur. Kërkesa është regjistruar në AKP me numrin e lëndës KPA16240
2. Për ta mbështetur kërkesën e tij, paraqitësi i kërkesës dorëzoi këto dokumente:
 - Fletën poseduese nr.4465, të datës 16 qershor 1997 të lëshuar nga Zyra Kadastrale për pronë të paluajtshme në Komunën e Ferizajt, ku është shënuar babai dhe xhaxhai i paraqitësit të kërkesës si bashkë-pronarë të pronës së kërkuar;
 - Aktgjykimin nr.P.br.653/96 të datës 30 janar 1997 të Gjykatës Komunale në Ferizaj, që vërteton se babai i paraqitësit të kërkesës është pronar i ½ pjesë së pronës së kërkuar, që është verifikuar pozitivisht nga ekipi verifikues i AKP-së;
 - Vendimin nr. 452-01/97-68 të datës 24 prill 1997 të lëshuar nga Zyra Republikane e Gjeodezisë – Zyra Kadastrale në Ferizaj për regjistrimin e pronës së kërkuar në emër të babait

dhe xhaxhait të paraqitësit të kërkesës sipas vendimit nr.P.br.653/96 të datës 30 janar 1997 të Gjykatës Komunale të Ferizajit (e verifikuar negativisht);

- Vendimin nr.P.br.89/58 të datës 20 tetor 1958 të Gjykatës së Qarkut Ferizaj, me të cilin shpallet i vdekur babai i paraqitësit të kërkesës.

Sipas raportit verifikues të datës 27 shtator 2011, ekipi verifikues i AKP-së ex-officio verifikoi Çertifikatën për të drejtat mbi pronën e paluajtshme nr.P-72217092-00137-0, të datës 11 shkurt 2011, të lëshuar nga Departamenti për Kadastër në Komunën Ferizaj dhe gjeti se regjistrimi i pronës së kërkuar është bërë sipas Aktgjykimit nr.P.br.653/96 të datës 30 janar 1997 të Gjykatës Komunale të Ferizajit në emër të babait dhe xhaxhait të paraqitësit të kërkesës.

3. Më 5 shtator 2007, ekipi njoftues i AKP-së e njoftoi pronën duke vendosur një shenjë ku pretendohet se ndodhet ajo. Në kohën e vizitës, prona u gjet si livadh i pa uzurpuar.
4. Më 9 maj 2007, I T , F I dhe Q O (në tekstin e mëtejme të gjithë referohen si: pala përgjegjëse në ankesë) iu drejtuan AKP-së si palë përgjegjëse në kërkesë. Ata nënshkruan Njoftimin e Pjesëmarrjes dhe pretenduar të drejtë ligjore mbi pronën e kërkuar. Ata gjithashtu deklaruan se e kishin blerë pronën e kërkuar përmes një marrëveshjeje joformale nga një palë e tretë, Mehmet Neziri, dhe pretenduan se kanë qenë në posedim të pronës së kërkuar që nga vitet e gjashtëdhjeta. Për t'i mbështetur pretendimet e tyre, ata dorëzuan si provë një kontratë të blerjes të lidhur ndërmjet kooperativës bujqësore dhe H N . Në këtë kontratë nuk përmendet ndonjë numër ngastre si dhe kontrata nuk është e vërtetuar në gjykatë. Përveç kësaj, ata dorëzuan disa deklarata të dëshmitarëve të cilat nuk janë vërtetuar nga gjykata.
5. Më 23 korrik 2012, KKPK-ja vendosi që ta zhvillojë një seancë dëgjimore me qëllim të ofrimit të disa informatave shtesë lidhur me kërkesën. Gjatë dëgjimit, paraqitësi i kërkesës konfirmoi se deri në vitet nëntëdhjeta, bashkëpronarët e pronës së kërkuar nuk ishin në dijeni se prona e cekur iu takonte atyre. Ai deklaroi se transferimi i pronës në emër të babait dhe xhaxhait të tij ishte bërë sipas vendimit nr.P.br.653/96 të datës 30 janar 1997 të Gjykatës Komunale të Ferizajit, dhe se edhe pas këtij vendimi asnjëri nga anëtarët e familjes nuk e kishte marrë posedimin mbi pronën e kërkuar. Ai gjithashtu pranoi se pas përfundimit të procedurës së trashëgimisë kur babai dhe xhaxhai i tij erdhën në posedim të pronës, ata zbuluan se prona e kërkuar ishte duke u shfrytëzuar nga njëri nga palët përgjegjëse në kërkesë, I T . Në anën tjetër, pala përgjegjëse në kërkesë, I T ,

deklaroj se ai e kishte blerë pronën në vitin 1969 nga një palë e tretë dhe që nga atëherë ai ka qenë në posedim të papenguar të pronës.

6. Pas dëgjimit, KKPK-ja më 5 shtator 2012, me vendimin KPCC/D/A/164/2012, vendosi që ta refuzojë kërkesën me arsyetimin se paraqitësi i kërkesës nuk ka arritur ta dëshmojë të drejtën e pronësisë apo ndonjë të drejtë tjetër pronësore mbi pronën e kërkuar menjëherë para apo gjatë konfliktit të viteve.
7. Vendimi iu dorëzua paraqitësit të kërkesës më 20 maj 2013 dhe të gjitha palëve përgjegjëse në kërkesë më 8 maj 2013.
8. Më 30 maj 2013, S R K (në tekstin e mëtejme: pala ankuese) dorëzoi një ankesë në Gjykatën Supreme duke kundërshtuar vendimin e KKPK-së.

Pretendimet e palëve

9. Pala ankuese thirret në shkeljen e të drejtave dhe vlerësimin e gabuar të fakteve nga ana e KKPK-së. Në ankesën e tij ai deklaroi se vendimi i KKPK-së ishte bazuar në deklaratat verbale të palëve përgjegjëse në kërkesë dhe në disa dokumente të cilat mund të jenë të falsifikuara, sepse ato nuk janë lëshuar në përputhje me ligjin. Prandaj, ai kërkon nga Gjykata Supreme që ta prishë vendimin e KKPK-së dhe t'ia njohë atij të drejtën e vet pronësore.

Arsyetimi ligjor

Pranueshmëria e ankesës

10. Ankesa është e pranueshme. Ajo është paraqitur brenda periudhës prej 30 ditësh sikurse parashihet me nenin 12.1 të Ligjit nr. 03/L-079.

Juridiksioni

11. Gjykata Supreme ka juridiksion për ta shqyrtuar ankesën.
12. Sipas nenit 3.1 të Ligjit nr. 03/L-079, Komisioni ka të drejtë në zgjidhjes së kërkesave që ndërlidhen me konfliktin e armatosur të viteve 1998/1999, kërkesat që ndërlidhen me të drejtat që

nuk mund të ushtrohen për shkak të rrethanave që ndërlidhen drejtpërdrejtë apo që rezultojnë nga konflikti i armatosur që ndodhi në Kosovë ndërmjet 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999.

13. Duke u bazuar në faktet e vërtetuara dhe deklaratimet e palëve, duhet të konkludohet se kontesti nuk është në juridiksionin e KKPK-së. Ndonëse pala ankuese në kërkesën e tij deklaroi se posedimi mbi pronën e kërkuar ishte humbur për shkak të konfliktit të armatosur të viteve 1998-99, kjo nuk buron nga provat e dorëzuara apo nga deklaratimet e tij.
14. Kur u pyet nga Sekretaria Ekzekutive, pala ankuese deklaroi se ai dhe vëllai i tij nuk ishin në dijeni për të drejtat e tyre pronësore sepse babai i tyre ishte i vdekur dhe ata i kishte rritur xhaxhai i tyre. Deri në miratimin e të drejtave të tyre të pronës me aktgjykimin nr.P.br.653/96 të datës 30 janar 1997 të Gjykatës Komonale të Ferizajit, ata nuk kishin ushtruar posedimin mbi pronën e kërkuar. Pas konfirmimit të së drejtës së pronësisë së tyre mbi pronën e kërkuar, ata u përpoqën të hyjnë në posedim por zbuluan se prona e tyre po shfrytëzohej nga njëri prej palëve përgjegjëse në ankesë. Në dëgjimin e zhvilluar nga KKPK-ja më 23 korrik 2012, vet pala ankuese përsëriti atë që ia tha Sekretarisë Ekzekutive.
15. Pas vlerësimit të fakteve të vërtetuara dhe deklaratimeve të palëve, Gjykata Supreme konkludon se është e qartë se ekziston një kontest rreth pronës së kërkuar, por ky kontest nuk ndërlidhet me konfliktin e armatosur të viteve 1998-99. Në fakt, pala ankuese asnjëherë nuk e ka marrë posedimin para fillimit të konfliktit të armatosur dhe qartazi nuk ka mundur ta humb atë gjatë atij konflikti.
16. Në qoftë se pala ankuese do të kishte pretendime legjitime lidhur me të drejtën e pronësisë mbi pronën e kërkuar, këto duhet të trajtohen se kërkesa të rregullta detyrimore dhe ato duhet të vendosen nga gjykatat e rregullta.
17. Në bazë të lartcekurave dhe në përputhje me dispozitën e nenit 12.2 të Ligjit nr. 03/L-079 dhe nenit 198, paragrafit 1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, është vendosur sikurse në dispozitivin e këtij Aktgjykimi.

Këshillë ligjore

18. Në përputhje me nenin 13.6 të Ligjit 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të rregullta apo të jashtëzakonshme juridike.

Sylejman Nuredini, Kryetar i Kolegjit

Willem Brouwer, Gjyqtar i EULEX-it

Rolandus Bruin, Gjyqtar i EULEX-it

Urs Nufer, Referent i EULEX-it